

Data: 20.07.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim instalim mbrojtje rele për bllokun gjenerator - transformator në 8 panelet e sistemit të mbrojtjes rele në HEC Koman ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË
NDRYSHME - 39300000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 200,000,000 (Dyqind milion) Lekë pa TVSH ose 2,135,155 (Dy milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 20.07.2026 është 93.67 Lekë/Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që Operatori Ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit :

Ligjin Nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar).

Vendim nr. 211, datë 9.4.2025 Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave. “Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Udhëzim nr. 24, datë 6.11.2025 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- ✚ Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- ✚ për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kjo kërkesë ka si qëllim sigurimin e faktit që operatori ekonomik ka përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të realizuar kontrata të ngjashme me atë që po kërkohet. Në këtë mënyrë, AK synon të sigurojë se operatori ka kapacitetin për të përmbushur kërkesat dhe për të ofruar shërbime apo produkte që janë të ngjashme në natyrë dhe në vlerë me ato që janë të parashikuara në kontratë. Përvojat e mëparshme në kryerjen e furnizimeve të ngjashme janë një indikator i rëndësishëm i aftësisë së operatorëve për të menaxhuar projekte dhe për të përmbushur afatet dhe standardet e kërkuara. Nëse një operator ka një histori të suksesshme të realizimit të kontratave të ngjashme, kjo ul mundësinë e dështimit të kontratës së re, duke e bërë procesin më të sigurt dhe më të besueshëm për palën kontraktuese.

Operatorët ekonomikë që kanë përvojë të mëparshme në fushat e ngjashme janë më të besueshëm në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që kërkohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për projekte që kërkojnë cilësi të lartë dhe përputhje me standardet. Përvoja e mëparshme tregon se operatori ka kapacitetin për të siguruar cilësinë dhe të përmbushë kërkesat kontraktuale.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ SSH/ISO 9001 - “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata mundëson një menaxhim të mirë të cilësisë, mbrojtje të mjedisit dhe siguri të punonjësve. Këto standarde janë të rëndësishme për të siguruar që operacionet e mirëmbajtjes të jenë efikase, të qëndrueshme dhe të sigurta për të gjitha palët e përfshira.

Konkretisht:

SSH/ ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026, jo më pak se 4 (katër) inxhinierë elektrik dhe /ose elektronik,:

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaratimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaratimit si:

✚ Kontratë pune të vlefshme;

✚ Diplomë e inxhinierëve;

Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Maj 2026 - Korrik 2026.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

Konkretisht: Kërkesa teknike që Operatori Ekonomik (OE) të ketë në stafin e tij minimalisht **4 (katër) inxhinierë elektrikë dhe/ose elektronikë me eksperiencë** është në përputhje dhe në përpjesëtim me objektin e kontratës, duke marrë në konsideratë natyrën specifike dhe kompleksitetin teknik të proceseve që parashikohen të realizohen gjatë zbatimit të projektit. Referuar kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike, realizimi i këtyre proceseve kërkon një nivel të lartë ekspertize dhe kompetence inxhinierike.

Zbatimi i kontratës kërkon angazhimin e personelit me nivel të lartë profesional, si dhe kryerjen e proceseve të specializuara inxhinierike nga inxhinierë elektrikë dhe/ose elektronikë me eksperiencë në zbatimin dhe menaxhimin e projekteve të kësaj natyre. Angazhimi i këtij personeli është i nevojshëm për të garantuar cilësinë teknike, sigurinë dhe

realizimin me sukses të punimeve dhe shërbimeve, në përputhje të plotë me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Gjithashtu, referuar metodologjisë së parashikuar për rinovimin e sistemit të mbrojtjeve të agregateve të HEC Koman, si dhe nevojës për minimizimin e kohës së qëndrimit të agregateve jashtë gatishmërisë, është e domosdoshme që OE të disponojë staf të mjaftueshëm dhe të specializuar. Një pjesë e konsiderueshme e proceseve përgatitore dhe inxhinierike duhet të realizohen paralelisht, ndërkohë që agregati është në operim, me qëllim që, gjatë periudhës së ndalimit të tij, të kryhen vetëm proceset që teknikisht kërkojnë nxjerrjen e agregatit jashtë pune.

Për sa më sipër, disponueshmëria e minimalisht **4 (katër) inxhinierëve elektrikë dhe/ose elektronikë me eksperiencë** vlerësohet e nevojshme për realizimin paralel dhe efikas të proceseve të punës, respektimin e afateve të zbatimit dhe minimizimin e ndikimit të punimeve në gatishmërinë operationale të agregateve të HEC Koman.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026 specialistët e çertifikuar si më poshtë:

- ✚ 2 (dy) specialist të çertifikuar për testimin dhe komisionimin e releve mbrojtëse (objekt prokurimi) nga prodhuesi/t ose autoritete çertifikuese të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi/t.
- ✚ 2 (dy) specialist të çertifikuar nga prodhuesi/t i sistemit DCS Scada në HEC Koman mbi sistemet 250SCALA ose autoritete çertifikuese të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi/t.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomat e inxhinierëve;

Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Maj 2026 - Korrik 2026.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

Konkretisht: Objekti i procedurës së prokurimit përfshin procese dhe detyra teknike të specializuara, të cilat kërkojnë domosdoshmërisht angazhimin e personelit të kualifikuar, të trajnuar dhe të çertifikuar për sistemet përkatëse dhe nuk mund të realizohen nga personel me kualifikim të përgjithshëm në fushën elektrike. Kjo kërkesë bazohet në arsye objektive teknike, të cilat lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e personelit dhe të impiantit, integritetin e sistemeve ekzistuese, si dhe garantimin e vazhdimësisë së operimit të agregateve.

a) Ndërhyrja në një agregat në operim me fuqi 170 MVA

Metodologjia e zbatimit parashikon demontimin dhe zëvendësimin e njërit sistem të mbrojtjes, ndërkohë që agregati vijon të jetë në operim dhe sistemi tjetër i mbrojtjes mbetet aktiv. Realizimi i këtij procesi kërkon ndërhyrje në qarqet e transformatorëve të rrymës dhe tensionit (CT/VT), si dhe në qarqet e stakimit të agregatit.

Një gabim gjatë këtyre ndërhyrjeve, si hapja e një qarku sekondar CT nën ngarkesë, gjenerimi i një komande të pavullnetshme stakimi ose çaktivizimi i paqëllimshëm i sistemit të mbrojtjes që mbetet në funksion, mund të krijojë rrezik të menjëhershëm për personelin, të shkaktojë daljen e agregatit nga puna, si dhe të ekspozojë gjeneratorin dhe transformatorin e bllokut ndaj dëmtimeve të rënda në rast defekti.

Për këtë arsye, procesi duhet të realizohet nga personel i trajnuar dhe me eksperiencë në ndërhyrjet në sisteme redundante të mbrojtjes, i aftë të zbatojë në mënyrë korrekte sekuencën e ndërhyrjes në sistemet A/B, duke garantuar që në çdo fazë të punimeve agregati të mbetet i mbrojtur.

b) Koordinimi, parametrizimi dhe testet e stabilitetit të mbrojtjeve diferenciale

Parametrizimi dhe komisionimi i funksioneve të mbrojtjes diferenciale, përfshirë 87B, 87REF dhe 87G, kërkon njohuri të specializuara në fushën e mbrojtjeve rele dhe eksperiencë në sistemet e mbrojtjes së blloqeve gjenerator–transformator.

Në veçanti, përcaktimi dhe verifikimi i parametrave që lidhen me rrymat e renditjes zero, harmonikat e tretë dhe të pestë, karakteristikat dhe ngopjen e transformatorëve të rrymës, rrymat e magnetizimit (*inrush current*), si dhe grupin vektorial të transformatorit, kërkojnë analizë dhe kompetencë të lartë teknike.

Parametrizimi i pasaktë i këtyre funksioneve mund të shkaktojë veprim të gabuar të mbrojtjeve gjatë defekteve të jashtme ose, në rastin më kritik, mosveprimin e tyre gjatë defekteve të brendshme në zonën e mbrojtur. Për këtë arsye, testet e stabilitetit dhe komisionimi duhet të kryhen nga personel i specializuar dhe me eksperiencë në parametrizimin dhe testimin e mbrojtjeve diferenciale të gjeneratorëve dhe transformatorëve të fuqisë.

c) Ndërhyrja në sistemin aktiv DCS SCALA 250

Objekti i kontratës përfshin gjithashtu konfigurimin dhe integrimin e sinjaleve në PLC-të e katër aggregateve dhe në sistemin SCADA të HEC Koman, të cilat janë pjesë e sistemit ekzistues DCS SCALA 250 dhe janë aktualisht në operim.

Ndërhyrja në këtë sistem kërkon njohuri të specializuara mbi arkitekturën, konfigurimin dhe funksionimin e sistemit ekzistues. Një konfigurim i pasaktë mund të ndikojë në vizualizimin dhe përpunimin e sinjaleve, menaxhimin e alarmeve, konfigurimin e aksesit dhe funksionimin e sistemit të kontroll-monitorimit të aggregateve. Gjithashtu, ndërhyrjet e paautorizuara ose të pakualifikuara mund të cenojnë integritetin funksional dhe konfigurimin ekzistues të sistemit.

Për këto arsye, ndërhyrjet në sistemin DCS SCALA 250 duhet të realizohen nga personel i trajnuar dhe i autorizuar nga prodhuesi i sistemit ekzistues, me njohuri dhe eksperiencë në arkitekturën dhe konfigurimin e këtij sistemi.

d) Njohja e sistemit ekzistues për integrimin dhe “mapping” korrekt të sinjaleve

Integrimi i sistemit të ri të mbrojtjes me sistemin ekzistues të kontroll-monitorimit, nëpërmjet protokollit IEC 60870-5-104, si dhe lidhja fizike e sinjaleve me hyrjet rezervë të PLC-ve ekzistuese, kërkojnë njohje të detajuar të arkitekturës, skemave elektrike dhe konvencioneve të sinjalizimit të sistemit të instaluar.

Hartëzimi (*mapping*) i saktë i sinjaleve është thelbësor për të garantuar përputhshmërinë ndërmjet sistemeve, identifikimin dhe vizualizimin korrekt të statuseve dhe alarmeve, si dhe ruajtjen e konfigurimeve dhe kopjeve rezervë (*back-up*) të sistemit ekzistues.

Për rrjedhojë, këto procese duhet të realizohen nga personel i specializuar dhe me njohuri të sistemit ekzistues, në mënyrë që integrimi të kryhet pa cenuar funksionalitetin, sigurinë dhe vazhdimësinë e operimit të sistemit DCS të HEC Koman.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, çertifikatë, deklaratë etj).

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e një Autorizimi nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për mallrat objekt prokurimi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave dhe ka suportin teknik të tij për projektimin, prodhimin dhe instalimet e testimet në vend. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.

Autorizimi i prodhuesit për shërbimet lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. Objekti i kësaj procedure prokurimi lidhet plotësisht me punime në sistemin SCADA të HEC Koman.

Sa me siper, Operatori Ekonomik që do të zbatojë këtë projekt duhet të sigurojë suportin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar të Sistemit ekzistues të kontroll-monitorimit 250 SCALA. Kjo vërteton që ky Operator do të ketë mbështetjen teknike të Prodhuesit të Sistemit ekzistues, për të bërë të mundur ndërhyrjet, punimet dhe kryerjet e shërbimeve në tërësi nga një staf i kualifikuar/certifikuar dhe me asistencë të vazhdueshme teknike, duke siguruar Autoritetin Kontraktor se kontrata do të zbatohet plotësisht dhe nuk do të ketë probleme dhe anomali gjatë zbatimit të këtij projekti.

Per me teper, duke marre parasysh rëndësinë e sistemit SCADA të HEC Koman, që është klasifikuar edhe nga autoriteti kombëtar i sigurisë kibernetike, si sisteme kritike, cdo ndërhyrje në SCADA është me rrisht për sigurinë. Autorizimi i prodhuesit na garanton AK që nuk do të riskohet apo cenohet siguria dhe funksionaliteti i sistemit nga ndërhyrja që do të bëhet për realizimin e objektit të procedurës së prokurimit.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për kredibilitetin në përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike.

Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/katalogëve teknikë për mallrat objekt prokurimi justifikohet nga nevoja për verifikimin e përputhshmërisë së plotë të produkteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Duke qenë se mallrat kanë karakter teknik dhe duhet të integrohen me sistemin ekzistues, katalogu shërben si mjet zyrtar për identifikimin e karakteristikave teknike, parametrave dhe performancës së tyre, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë në mënyrë objektive nëse produkti i propozuar përmbush kërkesat e vendosura.

Kërkesa që në katalog të shënohen qartë dhe në mënyrë të dallueshme artikujt e ofruar dhe specifikimet përkatëse synon të shmangë paqartësitë dhe interpretimet e ndryshme, duke siguruar transparencë dhe krahasueshmëri të ofertave. Kjo i mundëson Autoritetit Kontraktor të bëjë një vlerësim teknik të saktë dhe të verifikueshëm, duke garantuar që malli i furnizuar është në përputhje të plotë me kërkesat teknike dhe standardet e kërkuara në procedurën e prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve tip të kryera nga prodhuesi për projekte të ngjashme për rinovimet e sistemit të mbrojtjeve të gjeneratorëve dhe transformatorëve.

Argumentimi: Ky kriter është kërkuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", si dhe me nenin 40, pika 6, shkronjat **b)** dhe **c)**, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku parashikohet se autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të paraqesin dëshmi që vërtetojnë

përmbushjen e kërkesave minimale të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: **b)** fotografi ose katalogë teknikë dhe/ose **c)** dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, të cilat vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me standardet e aplikueshme dhe kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike. Dokumentacioni që dëshmon realizimin e mëparshëm të testeve tip përbën një element të rëndësishëm për vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të Operatorit Ekonomik. Rezultatet dhe raportet e këtyre testeve dëshmojnë aftësinë dhe eksperiencën e OE për kryerjen e proceseve të testimit në fabrikë, në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e specifikimeve teknike. Gjithashtu, eksperiencia e mëparshme në realizimin e testeve të kësaj natyre ofron siguri të arsyeshme se OE disponon njohuritë teknike, procedurat dhe kapacitetet e nevojshme për të realizuar në mënyrë korrekte testet e kërkuara gjatë zbatimit të kontratës, duke garantuar cilësinë dhe përputhshmërinë teknike të produkteve që do të furnizohen.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë propozimin teknik ku të paraqiten e skemat njëvijore të lidhjes si dhe funksionet e mbrojtjes dhe dublimi i tyre.

Argumentimi: Ky kriter është kërkuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", si dhe me nenin 40, pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është për të krijuar bindjen tek Autoritetin Kontraktor që Operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik të mjaftueshëm për dhënien e një oferte teknike të zhvilluar mjaftueshëm, për të provuar pajtueshmërinë e projektit të rinovimit të sistemit të mbrojtjeve, me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara. Gjithashtu realizimi i një propozimi teknik, dëshmon që OE ka kuptuar në parim detyrat që duhet të realizohen objekt prokurimi, dhe jep një siguri që është mjaftueshëm i specializuar për këtë natyrë punimesh.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

Grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike për objektin në fjalë, duke u bazuar në kërkesat funksionale të impiantit ekzistues, standardet shqiptare në fuqi, standardet ndërkombëtare IEC, si dhe kërkesat teknike të sigurisë për projektimin, prodhimin, testimin, instalimin dhe vënien në punë të mbrojtjeve rele per 8 panelet te 4 aggregateve ne HEC Koman. Seti i releve të reja për rinovimin e sistemit të mbrojtjeve, duhet të realizojë zgjidhje teknike të avancuar me rele dixhitale/numerike të gjeneratës më të re të provuar në industri, për mbrojtjen e gjeneratorit, transformatorit te fuqisë, transformatorëve te eksitimit e nevojave te brendshme dhe per supervizmin e qarkut te stakimit te çelsave 245kV te blloqeve GT, si dhe te kene performancë të lartë në frekuenca të ndryshme me vlera 50 Hz, 60 Hz dhe 16.7 Hz, me logjikë të programueshme sipas IEC 61131-3 dhe panel ndërveprues për vizualizimin online të proceseve. Kërkesa për performancë të garantuar matëse në frekuencat 50 Hz, 60 Hz dhe 16.7 Hz nuk lidhet me regjimin nominal të HEC Koman (50 Hz), por garanton që algoritmet matëse dhe mbrojtëse, veçanërisht mbrojtjet diferenciale (87G, 87B, 87REF) dhe mbrojtja tokë në stator, ta ruajnë saktësinë gjatë regjimeve kalimtare të nisjes dhe ndalimit të agregatit, kur frekuenca elektrike e gjeneratorit bie ndjeshëm nën vlerën nominale. Ky kapacitet shumëfrekuencësh siguron stabilitet dhe besueshmëri të mbrojtjes në të gjithë ciklin operativ të agregatit.

Për garantimin e sigurisë së veprimit dhe redundancën e plote te sistemit të mbrojtjes së gjeneratorit, te transformatorit te fuqisë, transformatorit te eksitimit e transformatorit ndihmës dhe te supervizmit te qarkut te stakimit te çelësave 245kV te blloqeve GT, te gjitha funksionet e mbrojtjeve, kërkohet të jenë të dubluara, si ne sistemin A ashtu edhe ne sistemin B te mbrojtjeve.

Përveç funksioneve te mbrojtjeve te releve egzistuese, ne setet e releve te reja te mbrojtjeve të të katër aggregateve duhet të konfigurohen dhe parametrizohen edhe funksionet shtese të listuara ne piken 3.4 si ne sistemin A ashtu edhe ne sistemin B te mbrojtjeve.

HEC Koman operohet nga një sistem kontroll-monitorimi i tipit DCS SCALA 250, i prodhuesit të sistemit ekzistues. Arkitektura përfshin nivelin e kontrollit me PLC të dedikuar për secilin agregat (Unit 1, Unit 2, Unit 3, Unit 4), nivelin e mbikëqyrjes me stacionet operatore SCADA, si dhe Engineering Station për konfigurim, mirëmbajtje dhe akses në distancë. Sistemi ekzistues i mbrojtjeve komunikon aktualisht me DCS-in nëpërmjet protokollit IEC 60870-5-104 dhe lidhjeve hardware.

Reletë e reja duhet të integrohen plotësisht në sistemin DCS SCALA 250 të HEC Koman. Monitorimi dhe komandat realizohen me MMS, ndërbllokimet dhe sinjalet e shpejta midis releve realizohen me GOOSE. Çdo funksion i ri (64S100%, 50BF, 60/1, oscilograf/SOE) konfigurohet dhe vizualizohet në HMI.

Të gjitha kërkesat e mësipërme në specifikimet teknike janë hartuar për të garantuar funksionalitetin e sistemit të ri të mbrojtjes rele në HEC Koman në përputhje me kushtet teknike dhe standartet në fuqi.

Njësia e Prokurimit